




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**Këshilli Gjyqësor i Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 7 pika 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 115 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 30 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 03/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datën 21 dhjetor 2023,

**Miraton:**

**RREGULLORE Nr. 15/2023**  
**PËR STATUSIN, KUSHTET DHE PROCEDURËN E EMËRIMIT TË**  
**PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton statusin, kushtet, procedurën e për zgjedhjes dhe emërimin e kryesuesit/anëtarëve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet ndaj Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:

- 1.1. **Këshilli** – Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.2. **PZAP** – Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- 1.3. **Kryesues i PZAP** – gjyqtarin e Gjykatës Supreme të emëruar nga Këshilli, i cili kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- 1.4. **Anëtar i PZAP** – gjyqtarin e Gjykatës së Apelit të emëruar nga Këshilli, i cili

kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;

- 1.5. **Njësia** – Njësinë për Inspektim Gjyqësor, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.6. **Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit** – Komision ad-hoc i themeluar nga Këshilli i cili shqyrton, analizon dhe vlerëson aplikacionin dhe dokumentet e bashkangjitura të gjyqtarëve aplikant për anëtar të PZAP;
- 1.7. **Komisioni për shqyrtimin e ankesave** – Komision ad-hoc i themeluar nga Këshilli për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të Komisionit për shqyrtimin e aplikacionit;
- 1.8. **Anëtar i komisionit** – anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë rregullore;
- 1.9. **Anëtar rezervë i komisionit** – anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili zëvendëson anëtarët e komisionit në rast të konfliktit të interesit apo rastet e tjera të pengesave eventuale gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar;
- 1.10. **Subjekti bartës i procesit të emërimit** – anëtari i Komisionit për shqyrtimin e aplikacionit, Komisioni për shqyrtimin e ankesave, zyrtarët e Njesisë dhe përdoret vetëm për qëllime të kësaj rregullore.

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

#### **Neni 4 Parimet**

1. PZAP, ushtron detyrat dhe aktivitetet në bazë të parimeve si në vijim:

- 1.1. **Parimi i Ligjshmërisë** – PZAP ushtrimin e aktiviteteve dhe detyrave të punës e bën në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore.
- 1.2. **Parimi i profesionalizmit** - PZAP ushtron detyra dhe përgjegjësi profesionale në përputhje me legjislacionin në fuqi. Anëtarët e PZAP përkushtohen ndaj zhvillimit të njohurive dhe praktikave të reja profesionale dhe ofrojnë shërbime cilësore.
- 1.3. **Parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë** - PZAP ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- 1.4. **Parimi i transparencës dhe llogaridhënies** - PZAP është organ transparent dhe llogaridhënës për punën dhe veprimet e tij, duke siguruar qasje në informacione relevante për të gjithë personat e interesuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 1.5. **Parimi i përfaqësimit gjinor dhe etnik** - Këshilli siguron që në përbërjen e PZAP të ketë përfaqësim të drejtë gjinor dhe etnik në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- 1.6. **Parimi i ruajtjes së fshehtësisë zyrtare** - PZAP ruan konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që dalin nga legjislacioni që ka të bëjë me qasjen në dokumente publike.



**Neni 5**  
**Statusi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

PZAP është organ i përhershëm dhe i pavarur, kompetent për të vendosur në lidhje me parashtrësit dhe ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 6**  
**Përfshirja nga përgjegjësi penale dhe civile e kryesuesit/anëtarëve të PZAP**

1. Kryesuesi/anëtarët e PZAP nuk mbajnë përgjegjësi penale apo civile për vendimet, mendimet e shprehura dhe veprimet e marra brenda fushës së përgjegjësisë si kryesues/anëtar të PZAP.
2. Këshilli njoftohet pa vonesë kur ngritet aktakuzë apo arrestohet kryesuesi/anëtarët e PZAP.

**Neni 7**  
**Kushtet për emërimin e kryesuesit/anëtarëve të PZAP**

1. Gjyqtari i cili aplikon për kryesues/anëtar të PZAP duhet të plotësojë kushtet si në vijim:
  - 1.1. të jetë gjyqtarë nga radhët e Gjykatës Supreme për kryesues të PZAP, ndërsa për anëtarë të PZAP të jetë gjyqtarë nga radhët e Gjykatës së Apelit;
  - 1.2. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, përjashtimisht masës vërejtje jo publike me shkrim;
  - 1.3. të ketë vlerësimin e performancës për tre (3) vitet e fundit shkëlqyeshëm apo shumë mirë.
2. Përjashtimisht, paragrafi 1 të këtij neni, të drejtë aplikimi për pozitën e kryesuesit/anëtarit të PZAP nuk kanë kandidatët të cilët kanë shërbyer në dy mandate qoftë në cilësinë e kryesuesit apo anëtarit të PZAP.

**Neni 8**  
**Shpallja e pozitës së lirë për kryesues/anëtar të PZAP**

1. Në rast se pozita e kryesuesit apo një anëtar i mbetet e zbrazët për shkak të parapara me legjislacionin në fuqi dhe këtë rregullorë, Këshilli brenda tridhjetë (30) ditëve do të zëvendësojë kryesuesin/anëtarin. Këshilli me vendim, shpallë konkurs për vendin e lirë për kryesues/anëtar të PZAP, i cili publikohet në faqen zyrtare të Këshillit dhe PZAP.
2. Këshilli njoftohet nga drejtori i Sekretariatit të PZAP, tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të kryesuesit/anëtarit të PZAP, ndërsa në rastet tjera Këshilli informohet menjëherë.
3. Shpallja e vendit të lirë përmban të gjitha informatat përkatëse për çdo pozitë, duke përfshirë:
  - 3.1. numrin e pozitës së lirë;
  - 3.2. kriteret rreth kualifikimit;

- 3.3. mënyrën e dorëzimit të aplikacionit;
- 3.4. afatin e fundit për dorëzimin e aplikacionit, që nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë; si dhe,
- 3.5. udhëzimin për pasojat që bartë kandidati në rast të mos dorëzimit të aplikacionit dhe dokumenteve mbështetëse, brenda afatit të paraparë me konkurs.

4. Para shpalljes së pozitës të lirë në PZAP, Këshilli bën vlerësimin e përbërjes aktuale të PZAP në pikëpamje të përfaqësimit gjinor dhe komunitetit jo shumicë. Nëse Këshilli gjen se ka nën përfaqësim gjinor dhe të komunitetit jo shumicë në përbërjen e anëtarëve të PZAP, atëherë shpallja për pozitë të lirë bëhet për kandidatët gjyqtarë nga gjinia, përkatësisht komuniteti jo shumicë i nën përfaqësuar.

#### **Neni 9** **Mënyra e aplikimit**

Kandidati duhet të dorëzojë aplikacionin e plotësuar në mënyrë të rregullt, fizike apo në mënyrë elektronike.

#### **Neni 10** **Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit**

1. Këshilli, për çdo konkurs të hapur themelon Komisionin për shqyrtimin e aplikacionit në bazë të kriterëve të aplikueshme sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara në Këshill.
2. Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit të kandidatit për kryesues/anëtar të PZAP themelohet nga Këshilli, i cili përbëhet nga tre (3) anëtarë, dy (2) prej tyre duhet të jenë anëtar të Këshillit dhe një (1) anëtarë të jetë nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, si dhe dy (2) anëtarë rezervë, prej të cilëve njëri vjen nga anëtarët e Këshillit, kurse tjetri nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme.
3. Këshilli, zgjedhë kryetarin e komisionit nga radhët e anëtarëve të rregullt të Komisionit për shqyrtimin e aplikacionit.
4. Gjatë vendosjes për përbërjen e Komisionit për shqyrtimin e aplikacionit, Këshilli merr parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin e komuniteteve jo - shumicë.
5. Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit është përgjegjës që në afat jo më larg se pesë (5) ditë të bëjë shqyrtimin e aplikacionit të kandidatit për kryesues/anëtar të PZAP.
6. Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit harton raport lidhur me kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet formale për emërimin e anëtarëve të PZAP i cili raport iu dorëzohet të gjithë gjyqtarëve të cilët përmes konkursit të hapur kanë aplikuar për të qenë pjesë e PZAP.
7. Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit të kandidatit për kryesues/anëtar të PZAP mbështetet nga stafi i Njesisë.



## **Neni 11**

### **Komisioni për shqyrtimin e ankesave**

1. Këshilli, për çdo konkurs të hapur themelon Komisionin për shqyrtimin e ankesave në bazë të kriterëve të aplikueshme sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara në Këshill.
2. Komisioni themelohet në përbërje prej tre (3) anëtarëve të rregullt, prej të cilëve dy nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe një (1) anëtarë nga Këshilli, si dhe dy (2) anëtarë rezervë, prej të cilëve njëri vjen nga anëtarët e Këshillit, kurse tjetri nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme.
3. Këshilli, zgjedh kryetarin e komisionit nga radhët e anëtarëve të rregullt të Komisionit për shqyrtimin e ankesave.
4. Gjatë vendosjes për përbërjen e Komisionit për shqyrtimin e ankesave, Këshilli merr parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin e komuniteteve jo - shumicë.
5. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të kandidatit për kryesues/anëtar të PZAP, të paraqitura ndaj vendimeve të Komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatit.

## **Neni 12**

### **Konflikti i Interesit**

1. Konflikt interesi paraqet çdo rrethanë e cila për subjektet bartëse të procesit të emërimit të kryesuesit/anëtarit të PZAP, do të konsiderohej si interes privat që ndikon, mund të ndikojë ose duket se do të ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tyre, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.
2. Subjektet bartëse të procesit të emërimit të kryesuesit/anëtarit të PZAP duhet të bëjnë përpjekje ta parandalojnë dhe/ose t'i shmangen çfarëdo situatë të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Shfaqja e ndonjë konflikt interesi do të jetë po aq e dëmshme për respektin e publikut për punën e kryer nga Këshilli sikur edhe vet konflikti aktual i interesit.
3. Në rast se gjatë procesit të emërimit të kryesuesit/anëtarit të PZAP, ndonjë subjekt bartës i procesit të emërimit beson se mund të ketë konflikt interesi, ai/ajo duhet ta njoftoj menjëherë me shkrim për këtë çështje kryetarin e Komisionit përkatës, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij/saj.
4. Në rast se konflikti i interesit lidhur me procesin e emërimit, paraqitet nga kryetarët e komisioneve përkatëse, të njëjtit me shkrim e njoftojnë Këshillin, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij/saj.
5. Subjektet bartëse të procesit të emërimit, me rastin e paraqitjes së konfliktit të mundshëm të interesit detyrohen që menjëherë të pezullojnë çfarëdo veprimi të mëtejshëm, deri sa të vendoset lidhur me përjashtimin dhe zëvendësimin e tij/saj, sipas përcaktimit të bërë me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni.

6. Në rast se subjektet bartëse të procesit të emërimit sipas këtij neni gjenden në një situatë të konfliktit të interesit me ndonjë kandidat dhe një fakt të tillë e kanë mbajtur të fshehur, për subjektin bartës të procesit, tërheq përgjegjësi disiplinore.

### **Neni 13** **E drejta e ankesës**

1. Kandidati si palë e pakënaqur ka të drejtë ankesë në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në Këshill, jo më vonë se tre (3) ditë pune pas pranimit të raportit nga ana e Komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve, në rast se konsideron se i ka plotësuar kushtet formale të parapara me nenin 7 të kësaj rregullore për aplikim si kryesues/anëtar i PZAP.

2. Komisioni për shqyrtimin e ankesave brenda pesë (5) ditëve nga dita e përfundimit të afatit për ankesë shqyrton të njëjtën dhe nëse gjen se ankesa është e bazuar merr vendim që Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit brenda pesë (5) ditëve, të shqyrtojë pjesën e vlerësimit ankimor. Vendimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave duhet të jetë i arsyetuar.

### **Neni 14** **Raporti final i komisionit për shqyrtimin e aplikacionit**

1. Pas përmbylljes së procedurës ankimore, Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit përpilon raportin final të kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet formale sipas kësaj rregullore për të qenë kryesues/anëtar i PZAP, të cilin raport e dërgon në Këshill për qëllim të emërimit të kandidatit.

2. Në rast se Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit ka konstatuar se nuk ka kandidat të cilët i plotësojnë kushtet formale të përcaktuara në këtë rregullore, i njëjti i propozon Këshillit që të ri-shpallë konkurs të ri për pozitën përkatëse.

### **Neni 15** **Procedura e votimit**

1. Pas pranimit të listës me kandidatin/kandidatët për të cilët nga Komisioni për shqyrtimin e aplikacionit është konstatuar se i plotësojnë kushtet formale për të qenë anëtar i PZAP, Këshilli vendos për emërim të kryesuesit/anëtarëve të PZAP.

2. Kandidati/kandidatët do të votohen nga Këshilli në të njëjtën kohë dhe me përdorimin e një fletëvotimi të vetëm që përmban emrat e të gjithë kandidatëve.

3. Anëtari i Këshillit mund të abstenojë nga votimi para fillimit të procesit të votimit. Asnjë anëtar nuk do t'i lejohet të abstenojë pas fillimit të procesit të votimit për kandidatët.

4. Këshilli, voton në mënyrë të fshehtë kandidatin/kandidatët që kanë plotësuar kushtet formale për të qenë kryesues/anëtar i PZAP. Secili anëtar i Këshillit voton në listën e kandidatëve numrin e kandidatëve për pozitën e shpallura të lira. Kandidati i cili në raundin e parë të votimit



merr shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm konsiderohet si i emëruar për pozitën e kryesuesit/anëtarit të PZAP.

5. Nëse në raundin e parë të votimit kandidati që nuk ka arritur të marrë shumicën e thjeshtë të votave, të nevojshme për vendet e lira do të zhvillohet një raund i dytë me kandidatët e mbetur. Në raundin e dytë të votimit nuk do të përfshihet kandidati i cili në raundin e parë të votimit nuk ka marrë së paku një votë.

6. Nëse në raundin e dytë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk merr shumicën e thjeshtë të votave, konkursi do të ri-shpallet nga Këshilli.

#### **Neni 16** **Procedura e emërimit**

1. Pas votimit, Këshilli brenda njëzet e katër (24) orëve, me vendim emëron kryesuesin/anëtarët e PZAP.

2. Vendimi i Këshillit për emërim të kryesuesit/anëtarëve të PZAP duhet të jetë i arsyetuar.

#### **Neni 17** **Procedura e ripërtëritjes së mandatit**

Në rast se kandidati aplikon për pozitën e kryesuesit/anëtarit të PZAP për një mandat të dytë, do të zbatohen të njëjtat rregulla të përcaktuara në këtë rregullore sikurse për emërimin sipas mandatit të parë.

#### **Neni 18** **Suspendimi dhe shkarkimi i kryesuesit dhe anëtarëve të PZAP**

1. Kryesuesi dhe anëtarët e PZAP suspendohen nga pozita e tyre në PZAP automatikisht, nëse të njëjtit nga Këshilli janë suspenduar për shkelje që lidhen me pozitën e gjyqtarit në gjykatën në të cilën shërben.

2. Gjatë kohës së suspendimit të kryesuesit të PZAP, Këshilli me vendim cakton ushtruesin e detyrës të kryesuesit të PZAP nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme.

3. Nëse Këshilli e anulon vendimin për suspendim për shkeljen që lidhen me pozitën e gjyqtarit, kryesuesi dhe anëtarët e PZAP kthehen përsëri në pozitën e tyre si kryesues/anëtar i PZAP, nëse vendimi i nxjerrë është brenda mandatit të tyre.

4. Kryesuesi dhe anëtarët e PZAP mund të shkarkohen në këto raste:

- 4.1. humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkaqe mjekësore të vërtetuara;
- 4.2. dështimin e vazhduar për të marrë pjesë në veprimtaritë e PZAP për më gjatë se tre (3) muaj;
- 4.3. në rast të shqiptimit të masës disiplinore të transferimit të përhershëm në një

gjykatë të nivelit më të ulët.

### **Neni 19 Procedura për shkarkim**

1. Inicimi i procedurës për shkarkim të anëtarit të PZAP bëhet në Këshill, përmes kërkesës që e parashtron kryesuesi i PZAP. Ndërsa për kryesuesin inicimi i procedurës për shkarkim bëhet zyrtarisht nga Këshilli.
2. Kërkesa për iniciimin e procedurës duhet të përfshijë të dhënat e anëtarit dhe arsyet për shkarkim sipas neni 17 paragrafit 4 të kësaj rregullore.
3. Këshilli, me rastin e pranimit të kërkesës autorizon drejtorin e Sekretariatit të PZAP për mbledhjen e të dhënave të nevojshme që mund të shërbejnë për marrjen e vendimit, i kërkon sqarime anëtarit të PZAP që t'i deponoj me shkrim. Pas vlerësimit të të gjitha rrethanave Këshilli merr vendim të arsyetuar për shkarkimin e anëtarit të PZAP.

### **Neni 20 Përfundimi i mandatit**

1. Mandati i anëtarit të PZAP përfundon me:

- 1.1. vdekje;
- 1.2. pushimin e statusit të gjyqtarit;
- 1.3. skadimin e mandatit;
- 1.4. dorëheqje, duke i ofruar Këshillit njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditëve;
- 1.5. arrijten e moshës së pensionimit;
- 1.6. është dënuar për vepër penale me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- 1.7. në rast të ngritjes në detyrë në një gjykatë të nivelit më të lartë.

### **Neni 21 Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohen të gjitha dispozitat e akteve nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë rregullore.

### **Neni 22 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.




Albert Zogaj,



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 28. 12. 2023

INFORMACIONET PËR KANDIDATIN INFORMACIJE O KANDIDATU											
 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  APLIKACION/ SHPREHJE INTERESI PËR POZITËN KRYESUES/ANËTAR TË PZAP-së  PRIJAVA ZA POZICIJU/ISKAZIVANJE INTERESOVANJA ZA PRESEDVAJUÇEG/ÇLANA IPŽP-a	Emri (emri i prindit) mbiemri /Ime (ime roditelja) prezime										
	<table border="1" style="width: 100%; height: 20px;"> <tr> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> </tr> </table>										
	Numri personal / Lični broj										
	Gjykata në të cilën ushtron funksionin/Sud u kome vrši funkciju:										
	Adresa e banimit/Adresa stanovanja:										
Nr. i telefonit/Broj tel:											
E-mail adresa:											
<b>Pozita për të cilën ka aplikuar</b>  Pozicija za koju se prijavila											

#### UDHËZIMET / UPUTSTVA

- Kandidati duhet të plotësojë aplikacionin në mënyrë elektronike ose me shkrim në mënyrë të qartë duke përdorur lapsin me ngjyrë të kaltër. / Kandidat je dužan popuniti prijavu elektronskim putem ili pisanim, čitko i koristeći olovku plave boje.
- Kandidati duhet të plotësojë aplikacionin në tërësi. / Kandidat je dužan popuniti prijavu u potpunosti.
- Kandidati është i obliguar të shënojë „P/P“ (pa përgjigje) në hapësirën e pyetjes në të cilën nuk ka përgjigje. Aplikacioni i paplotësuar mund të shkaktojë eliminim të kandidatit nga përzgjedhja për pozitën e aplikuar. Të gjitha të dhënat e parashtruara nga kandidati i nënshtrohen procesit të verifikimit. / Kandidat je dužan obeležiti određeni prostor sa „B/O“ (bez odgovora) ispod pitanja na koje nema odgovor. Nepotpuna prijava može prouzrokovati eliminaciju kandidata iz daljeg postupka. Navedene informacije od strane kandidata biće podređene procesu verifikacije.
- Kandidati është i obliguar t'ia bashkangjesë aplikacionit të gjitha dokumentet e kërkuara sipas Konkursit. / Kandidat je obavezan pridružiti prijavi svu dokumentaciju prema tekstu Konkursa.
- Kandidati është i obliguar t'a nënshkruajë aplikacionin dhe shënojë datën e dorëzimit. Aplikacioni i cili nuk është i nënshkruar nuk do të merret parasysh. / Kandidat je dužan potpisati prijavu i navesti datum predaje. Nepotpisana prijava neće biti uzeta u obzir.
- Kandidati duhet t'a dorëzojë aplikacionin personalisht, bashkë me të gjitha dokumentet e bashkangjitura apo të njëjtën ta bëjë përmes postës në adresën e cekur në Konkurs. / Kandidat je obavezan predati prijavu lično, uz svu propratnu dokumentaciju, ili da isto izvrši putem redovne pošte na adresu navedenu na Konkursu.
- Aplikacioni pranohet nga KGJK me shënim të datës së aplikimit. Në qoftë se dërgesa bëhet përmes postës, e njëjta do të jetë e vlefshme nëse mban vlen me datë kur aplikacioni në pozitë të caktuar ishte i mundur sipas Konkursit. / Prijavu prihvata SSK. Na istoj se mora nalaziti datum prijave. Ukoliko je pošiljka izvršena putem redovne pošte, ista će se smatrati validnom ukoliko sadrži pečat datuma unutar datuma predviđenih Konkursom, kada se kandidat mogao prijaviti.
- Aplikacioni dhe dokumentet e bashkangjitura nuk kthehen. / Prijava i propratna dokumentacija neće biti vraćeni kandidatu.



## TË DHËNAT PERSONALE TË KANDIDATIT/ LIÇNI PODACI KANDIDATA

Emri (emri i prindit) mbiemri <i>Ime (ime roditelja) prezime</i>			
Mbiemri i vajzërisë <i>Djevojačko prezime</i>		Data dhe vendi i lindjes / <i>Datum i mjesto rodenja</i>	
Gjinia/ <i>Pol</i>	mashkull / <i>muški</i>	Femër / <i>ženski</i>	Nacionaliteti / <i>nacionalnost</i>
Nënshtetësia / <i>Državljanstvo</i>		Nënshtetësia tjetër (nëse keni) <i>Drugo državljanstvo (ako imate)</i>	

## VLERËSIMI I PERFORMANCËS / VREDNOVANJE RADNOK UCINKA:

Periudha e vlerësimit të përformancës dhe shkalla e vlerësimit: Period vlerënohja rada i stepen vlerënohja:	
---	--

## PËRVOJA E PUNËS/ RADNO ISKUSTVO

Kandidati duhet të fillojë nga vendi i tanishëm i punës, duke shënuar të gjitha vendet tjera të punës. Në qoftë se kandidati i duhet hapësirë shtesë, i njëjti mund të shfrytëzojë hapësirën shtesë në fletën që gjendet në fund të aplikacionit, apo mund të shtojë rreshtë të rinj.  
Kandidat treba započeti sa svojim sadašnjim radnim mestom. Ukoliko je kadidatu potreban dodatni prostor, isti može koristiti dodatni list priložen na kraju prijavnog obrasca ili može ubaciti dodatne redove.

Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / <i>Naziv radnog mesta</i>	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	
Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / <i>Naziv radnog mesta</i>	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	
Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / <i>Naziv radnog mesta</i>	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	

Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / <i>Naziv radnog mesta</i>	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	
Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / <i>Naziv radnog mesta</i>	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	
Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
<b>PËRVOJA E PËRGJITHSHME E PUNËS UKUPNO RADNO ISKUSTVO</b>	
	Vite/Godina   Muaj/Meseci   Ditë/Dana
Kandidati duhet të theksojë numrin e përgjithshëm të viteve të eksperiencës profesionale. / <i>Kandidat treba navesti ukupno relevantno radno iskustvo.</i>	

<b>Procedura Disiplinore / Disciplinski postupak:</b>
<i>Përshkruaj / Opišite:</i>

<b>Precedenti penal / Krivicni presedan:</b>
<i>Përshkruaj / Opišite:</i>



**DEKLARATA / IZJAVA**

- Me këtë deklaroj që kundër meje nuk është ngritur aktakuza e as nuk është nxjerrë aktgjykimi jo i plotfuqishëm dënues për një vepër penale të caktuar para gjykatës kompetente. / Ovim izjavlujem da protiv mene nije potvrđena optužnica, niti je izrečena nepravosnažna osuđujuća presuda za određeno krivično djelo pred nadležnim sudom;
- Me këtë deklaroj që pajtohem që të dhënat e mia personale të shfrytëzohet në procedurën konkurrese dhe për nevojat e KGJK-së e në pajtim me Ligjin Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin Nr.06/L-054 për Gjykatat dhe ligje tjera relevante. / Ovim izjavlujem da sam saglasan(a) da se moji lični podaci obrađuju u konkursnim procedurama za potrebe SSK, a u skladu sa Zakonom br.06/L-055 o Sudskom savetu Kosova, Zakonom br.06/L-054 o Sudovima, kao i drugim pozitivnim propisima;
- Me këtë deklaroj që pajtohem që informacionet lidhur me procedurën e rekrutimit të i marr përmes postës elektronike, përmes mesazheve SMS apo komunikimit me e-mail. / Ovim izjavlujem da sam saglasan(a) da obavesti o konkursnoj proceduri u kojoj učestvujem primam elektronskim putem, obaveštavanjem putem SMS poruka i/ili e-mail poruka;
- Me këtë deklaroj që jam i/e njoftuar që në faqen e internetit të KGJK-së gjenden të gjitha lajmërimet relevante lidhur me procedurën e rekrutimit, si dhe që jam i informuar që nuk do të më dërgohen përmes postës së rregullt apo telefonit lajmërimet mbi çështje për të cilat jam lajmëruar në mënyrë elektronike. / Ovim izjavlujem da sam upoznat(a) da se na službenoj internet (veb) stranici SSK, nalaze sva relevantna obaveštenja vezana za sprovođenje konkursnih procedura, te da sam informisan/a da mi se neće dostavljati pismena i telefonska obaveštenja o stvarima o kojima sam obavješten/a elektronskim putem.

*Nën përgjegjësinë materiale dhe penale konfirmoj që informacionet që gjenden në këtë aplikacion si dhe ato që gjenden në dokumente tjera të bashkangjitura si pjesë përbërëse e aplikacionit janë të sakta. Kuptoj që jam nën obligim të përhershëm të përmirësoj çdo informacion të pasaktë dhe të dërgoj çdo informacion relevant të cilin e mësoj pas dërgimit të këtij aplikacioni. Po ashtu kuptoj që mund të eliminohem nga mundësia për emërim në pozitë në të cilën aplikoj, respektivisht që mund të shkarkohem nga detyra e gjyqtarit në qoftë se konstatohet që kam dhënë informacione të pasakta apo kam shpër në konkludime të pasakta.*

*Pod materijalnom i krivičnom odgovornošću potvrđujem da su informacije navedene u ovom obrascu, kao i u svim dokumentima podnesenim kao njegov sastavni deo, istinite i tačne. Shvatam da sam pod trajnom obavezom da ispravim svaku netačnu informaciju i da dostavim svaku drugu relevantnu informaciju koju saznam nakon podnošenja ovog obrasca. Isto tako razumem da mogu biti isključen(a) iz razmatranja za imenovanje na položaj za koji sam se prijavio(la), odnosno da mogu biti razrešen(a) sa sudske funkcije ukoliko se ustanovi da neki od podataka koje sam dostavio(la) nije tačan ili navodi na pogrešno zaključivanje.*

**Nënshkrimi /Potpis****Vendi / Mesto****Data / Datum**